

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Tema:
**KARAKTERISTIKAT DHE SPECIFIKAT E USHTRIMEVE PËR
FORCË NË FITNES DHE BODYBUILDING**

Mentori:
Prof.dr. Hasim Rushiti

Kandidati:
Betim Krasniqi

Prishtinë, 2018



Përmbajtja:

1.Hyrje	1
2.Rëndësia e stërvitjes së forcës në aktivitete sportive	3
3.Qëllimi i punimit	7
3.1.Benifitet e të ushtruarit me pesha	7
3.2. Klasifikimi i mjeteve në fitnes	9
3.3.Karakteristikat e lëvizjeve – ushtrimeve	10
3.4.Rëndësia e frymëmarrjes	11
4.Stërvitja individuale e forcës	12
5. Modeli i stërvitjes me pesha	13
5.1.Modeli i një orë stërvitje per zhvillimin e qëndrueshmërisë muskulore – muskujve te gjoksit	13
5.2.Modeli i një ore stërvitore për zhvillimin e muskujve të shpinës	17
5.3.Model i ushtrimeve për zhvillimin e muskujve të barkut	24
5.4.Ushtrimet në vegla për muskujt e kofshës (quadriceps)	29
5.5.Ushtrime per zhvillimin e muskujve te tricepsit	33
6. Përcaktimi i vëllimit të ngarkesave	37
7. Parimet themelore gjatë të ushtruarit	39
7.1.Parimet nutritive – aplikimi i drejtë i ushqimit	39
7.2.Lloje të ndryshme të ushqimeve	40
8.Rekomandime dhe udhëzime praktike	41
8.1.Përfundimi	42
8.2. Resyme	43
9. Literatura	44

1. Hyrje

Në fokus të këtij punimi të diplomës master , synimi qëndron në trajtimin e ushtrimeve për forcë të cilat mundë të realizohen me mjete të ndryshme të fitnesit si dhe rekuizita adekuata për sportin e badibildingut.

Ushtrimt e tilla mundësojnë diapazon të gjerë të zhvillimit të faktorit gjeneral motorik, siç është forca.

Tanimë të ushtruarit me rekuizita të ndryshme, ne klubet e fitnesit dhe badibildingut, janë bërë pjesë e pashmangshme dhe sistematike e programit dhe procesit stërvitorë të sportistëve. Pavarësisht prej orientimit dhe llojit të aktivitetit sportiv, trajnerët e përgatitjes kondicionale përpilojnë programe dhe modele adekuate të stërvitjes në fitnes.

Përveç tjerash, me këtë rast do të trajtohen parimet bazë të aplikimit të rekuizitave, karakteristikat themelore , llojet funksionaliteti dhe aplikimi praktik i tyre.

Ushtrimet me pesha jo vetëm për sportistët, por kohëve të fundit, po gjejnë aplikim të madh edhe për qëllime rekreative, rehabilituese, te pjesëtarët e ushtrisë, policisë dhe në përgjithësi te një numër i madh i popullatës pa dallim moshe, gjinie apo profesioni.

Në hulumtimet e deritanishme të aftësive motorike është argumentuar se se forca është ndër aftësitë themelore vendimtare për funksionim efikas të sistemit të njeriut, përkryerjen e operacioneve të ndryshme motorike si dhe identifikimin e somatotipit. Nuk ekziston, në të vërtet, asnjë akt motorik i cili të paktën pjesërisht nuk varët nga forca. Për rrjedhoj njohja e ushtrimeve të forcës për bën një njohuri të rëndësishme për programimin e suksesit në cilindoo aktivitet kineziologjik. Hulumtimet e deritanishme të orientuara rreth njohjes sa ma të mire të hapësirës motorike kanë qar deri tek identifikimi i këtyre faktorëve aksional dhe topologjik të forcës:

Ky punim do të tregojë se stërvitja e forcës e bërë mirë , jo vetëm që nuk dëmton, por përkundrazi, ndihmon në sportet kulminante individuale. Pra punimi argumenton se ushtrimet e forcës duhet të integrohen në programet stërvitore të sportistëve të disiplinave sportive sepse mundësojnë një përmirësim të ndjeshëm të aftësive fizike të tyre.

Punimi si fillim do të shqyrtojë rëndësinë e stërvitjes së forcës në sporte duke dhënë edhe një panoramë historike se si është popullarizuar më së shumti kohëve të fundit dhe se si

perceptimi dominues për stërvitjen lidhet kryesisht me përfitimet në aspektin estetik. Kapitulli në vijim ndalet me hollësi tek stërvitja individuale e forcës duke analizuar gjashtë fazat e trajnimit të forcës dhe duke parashtruar argumentet dhe faktet se përse stërvitja e forcës është e dobishme për sportet në përgjithësi.

Në vijim punimi thellohet më shumë në mënyrë mëkonkrete tek stërvitja e forcës duke analizuar dy modele të kësaj lloji stërvitje. Së pari modelet e stërvitjes së forcës pa pesha ose duke shfrytëzuar vetëm peshën e trupit. Së dyti modelet e stërvitjes së forcës me pesha. Mandej punimi shqyrton në hollësi impaktin që kanë tek muskujt ushtrimet e forcës. Në mbyllje tema e diplomës përfundon me disa rekomandime praktike për stërvitjen e forcës dhe përshtatjen e saj për sportistët e sporteve luftarake.

Pikërisht, ky edhe është motivi kryesorë i realizimit të këtij punimi, duke paraqitur me disa shembuj konkret të lëvizjeve për zhvillimin e forcës muskulare.

Sado që në praktikë këto lëvizje duken të thjeshta dhe të lehta, megjithatë konceptimi dhe programimi i mirë i tyre mundë të kenë efekte shumë më shumë pozitive ndaj çdo forme tjetër të zhvillimit të forcës.

Në këtë punim është dhënë kompleksi i lëvizjeve për forcë i përbërë prej gjithsej 19 ushtrimeve me përshkrimin terminologjik si dhe paraqitjen grafike. Për çdo ushtrim veq e veq është përshkruar *pozita fillestare* e subjektit, detyra – ku është përshkruar shkurtimisht struktura e lëvizjes që realizohet, *qëllimi* i realizimit të lëvizjes /ushtrimit/ me ndikim në muskuj dhe grupe të caktuara muskulare, si dhe në fund *numri i përsëritjeve* për çdo ushtrim.

Vështërsitë më të mëdha në përgatitjen e këtij kompleksi të lëvizjeve ka qenë përshkrimi terminologjik i lëvizjeve për shkak të mungesës së unifikimit të terminologjisë sportive në gjuhën shqipe.

2.RËNDËSIA E STËRVITJES SË FORCËS NË AKTIVITETE SPORTIVE

Përmirësimi i pamjes së jashtme të trupit është bërë një ndër gjërat më të rëndësishme për rininë kosovare madje një pjesë e mirë e tyre kur flasin për sport menjëherë mendja iu shkon tek forma e pëlqyeshme fizike. Nga ana tjetër aspekti i ndërtimit të trupit për sportet kulminante nuk është konsideruar si parakusht për arritjen e rezultateve të mira sportive. Megjithatë hulumtimet kanë treguar se sportistët e suksesshëm tregojnë ngjashmëri në ndërtimin trupor, dhe këto shprehen më shumë duke përparuar. Pra këto veçori fizike theksohen më shumë kur sportisti arrin nivel më të lartë në sportin kulminant.

Forcimi dhe zhvillimi i përgjithshëm, harmonik dhe proporcional i muskulaturës së përgjithshme të trupit nëpërmjet ushtrimeve të fitnesit paraqet vetëm njërin nga manifestimet e jashtme. Megjithatë aspekti estetik i pamjes së jashtme nuk është përfitimi i vetëm që vjen nga ushtrimet fizike të forcës në gym. Duke forcuar dhe zhvilluar muskujt në organizëm, përveç hijeshisë së paraqitjes, bëhen edhe shumë ndryshime tjera pozitive siqjanëpërmirësimi i funksionimit të gjithëmbarshtëm i organeve të brendshme dhe përmirësimi i qarkullimit të gjakut. Falë ushtrimeve fitnes trupi bëhet gjithnjë më i fuqishëm dhe i qëndrueshëm sepse forcohet sistemi imunitar ndërkohë që lëkura e trupit bëhet më elastike. Po ashtu arrihet zvogëlimi i shtresës dhjamore midis lëkurës dhe muskujve dhe bëhet evitimi i disa sëmundjeve që shkaktohen si pasojë e mbipeshës, respektivisht sasisë së tepër të dhjamit. Gjithashtu ushtrimet e rregullta dhe sistematike të të forcës kanë një ndikim të madh të madh në aspektin psikologjik të individit. Ato ndikojnë nëforcimin dhe kalitjen e vullnetit, vendosshmërisë, këmbënguljes, disiplinës dhe aftësisë për tejkalimin e vështirësive dhe pengesave të natyrës së ndryshme gjatë përditshmërisë. Ushtrimet e forcës pra, përveç që ndikojnë në forcimin dhe zhvillimin e muskujve dhe aftësitë e gjithëmbarshtëme fizike, ndikojnë tejet pozitivisht edhe në vetë disiplinën mendore, respektivisht psikikën e njeriut, duke qenë më i disponuar, më kreativ në shkollë, punë, në jetën kulturo-zbavitëse dhe në veprimtarit tjera të përditëshme. Vlen të përmendet se vetë pamja fizike e trupit pasqyron dhe zbulon në masë të madhe edhe vetë mënyrën e jetesës, veçmas sjelljet dhe raportin ndaj trupit. Ndryshimi i pamjes së trupit përmes ushtrimeve të fitnesit si dhe krijimi i parakushteve të tjera të domosdoshme, ndikon dhe

reflektohet dukshëm edhe në ndryshimin pozitiv të jetës së njeriut, që pos tjerash nënkupton ushqimin dhe gjumin e rregullt si dhe punën dhe pushimin e planifikuar. Këto janë ndyrshime që krijojnë të gjitha parakushtet për një jetë të qetë dhe të shëndoshë.

Aftësia njerëzore për të gjeneruar forcë muskulore ka magjepsur njerëzimin përgjatë shumicës së historisë për aq sa mbahet mend. Jo vetëm që ka nivele të mëdha të forcës muskulore që intrigojnë njerëzit nga perspektiva argëtuese, por, më e rëndësishmja, nivele të larta të forcës që janë kritike për mbijetesën. Edhe pse zhvillimet moderne teknologjike mund të kenë ndryshuar nevojën për të gjeneruar nivele të larta të forcës për shumë aktivitete të përditshme, forca është ende një nga tiparet themelore fizike të nevojshme për mbijetesën njerëzore. Ndërkaq përdorimi i ushtrimit të rezistencës të llojeve dhe formave të ndryshme është bërë shumë popullore gjatë 50 viteve të fundit, origjina e aktiviteteve të tilla mund të gjurmohet në kohët e lashta. Gara për të arritur rezultate gjithnjë e më të larta sportive ka bërë që të rritet ndjeshëm përdorimi i trajnimit të forcës nga të gjithë atletët për të përmirësuar performancën sportive.

Çelësi i popullaritetit të saj të ri kur futemi në shekullin 21 është koncepti i trajnimit 'sportiv' të posaçëm për atletët. Studimet shkencore të dekadave të fundit i kanë thelluar gjithnjë e më shumë njohuritë për sa i përket dobisë së ushtrimit të forcës. Pavarësisht këtyre studimeve, fusha e forcës dhe e kondicionimit sidomos në Kosovë, por edhe në vende të tjera ngelet e mbushur në jetën e përditshme me ide të gabuara apo mite urbane që nuk mbështeten tek njohuritë e shëndosha shkencore. Kjo mosnjohje e mirë e përdorimit të ushtrimeve të forcës bën që shpesh trajnerët apo sportistët në Kosovë t'i neglizhojnë, t'i shmangin ose të mos i përdorin fare ato për rritjen e performancës sportive.

Historia e trajnimit të forcës jep një perspektivë të rëndësishme se ku kemi qenë dhe ku mund të shkojmë me këtë fushë të rëndësishme të trajnimit në zhvillimin sportiv. Çelësat për recetën optimale të stërvitjes janë njohuritë shkencore dhe përvoja e pasur të aplikuara në procesin e kujdesshëm të hartimit të programit stërvitor. Nevojitet një qasje sistematike e mbështetur në njohuritë shkencore dhe praktikat më të mira perëndimore për zhvillimin e këtyre programeve. Nevojiten studim të vazhdueshme, vlerësime të matura, dhe gjykimet e kujdesshme për sa i përket hartimit të një programi stërvitor për atletin. Në këtë kapitull do të prezantohet një perspektivë historike dhe disa parime themelore për të fituar një bazë të shëndoshë të njohurie për stërvitjen e forcës.

Industria e stërvitjes është rritur në mënyrë astronomike gjatë dekadave të fundit mirëpo gjatë historisë së saj, ka pasurdisa individë që kanë luajtur një rol kyç në promovimin e ushtrimit të rezistencës për qëllime sportive dhe fitnesi.

Në hulumtimet e deritanishme të aftësive motorike është argumentuar se se forca është ndër aftësitë themelore vendimtare për funksionim efikas të sistemit të njeriut, përkryerjen e operacioneve të ndryshme motorike si dhe identifikimin e somatotipit. Nuk ekziston, në të vërtet, asnjë akt motorik i cili të paktën pjesërisht nuk varët nga forca. Për rrjedhoj njohja e ushtrimeve të forcës për bën një njohuri të rëndësishme për programimin e suksesit në cilindoo aktivitet kineziologjik. Hulumtimet e deritanishme të orientuara rreth njohjes sa ma të mire të hapësirës motorike kanë qar deri tek identifikimi i këtyre faktorëve aksional dhe topologjik të forcës:

Faktorët aksional të forcës,	Faktorët tipologjik të forcës,
forca eksplozive,	forca e duarve dhe kraharorit
forca statike,	forca e trupit
forca repetitive	forca e këmbëve.

Forca është aftësi motorike e doemosdoshme sepsepa forcë nuk mundet të ekzekutohet asnjë aktivitet motorik. Forca është përkufizuar si aftësi e njeriut që përmes tendosjes ose kontraktimit të muskujve përballon rezistencën e jashtme.

Në këtë punimdo të paraqiten disa programthemeloreqë përdoren zakonisht në rritjen e forcës në sporte të ndryshme.

1. Programipër zhvillimin e forcës maksimale,
2. Programet përzhvillimin e forcës eksplozive,
3. Programet përzhvillimin e mases së muskujve (hipertrofiamuskulare) dhe
4. Programet përzhvillimin e qëndrueshmërisë së forcës muskulore.

Të ndihesh i shëndetshëm, i fortë dhe i aftë për kryerjen e detyrave në jetën e përditshme, stërvitje apo në gara është qëllimi kryesor i çdo individi në të gjitha sportet. Ushtrimet e forcës mundësojnë funksionimin efikas të trupit gjatë kryetjes të cilës punë apo detyrë fizike në jetën

e përditshme, stërvitje apo në gara. Ushtrimet e forcës mund të jenë të përgjithshme (nënkupton gjendje optimal të shëndetësore dhe gjendje të mirë fizike) dhe specifike (definojnë aftësitë fizike të veçanta për arritjen pikërisht qëllimet e caktuara në sport apo jetën e përditshme). Përmirësimi dhe përparimi i forcës si aftësi fizike varet kryesisht nga objektivi i dëshiruar dhe qëllimit ivendosur. Kjo gjërrihet duke përzgjedhur aktivitetin e duhur fizik me intensitet të përshtatshëm, me kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e duhur brenda një periudhe të caktuar. Zgjedhja e një aktiviteti fizik varet nga preferencat motorike dhe aftësitë funksionale, njohurit motorike, dëshirave dhe mundësive të individit. Është mirë të zgjedhim forma të shumta të aktivitetit fizik për shkak të kushteve klimatike, stinëve dhe ofertës së vendit në të cilën jeton sportisti çka mundëson ndikim të barabartë në shumë karakteristika antropologjike. Arritja e ndryshimeve pozitive mund të ndodhë vetëm nëse pas ngacmimit të shkaktuar nga ndikimi i ushtrimit fizik, ndodh përshtatja e organizmit ndaj ngarkesave të rritura apo të tjera.

Adaptimi do të ndodhë nëse aktiviteti fizik me ushtrime të forcës kryhet mjaft shpesh dhe gjatë, dhe nëse intensiteti i punës është i lartë sa të shkaktojë ngacmim. Aktivitetet garuese sportive me saktësi përcaktojnë se cilat karakteristika dhe aftësi të kërkuara janë të nevojshme për pasur kontribut garues efektiv në çdo sport. Nga ky fakt, problemi i cili trajtohet në këtë punim është sa i rëndësishëm aq edhe aktual, sepse në të gjitha sportet, përfshi këtu sportet luftarake, ndihet gjithë e më tepër nevoja për njohjen e ndikimit të ushtrimeve të forcës në zhvillimin e përgjithshëm fizik ashtu sikurse edhe në atë specifik.

3.Qëllimi i punimit

Qëllimi kryesorë i këtij punimi qëndron në analizën e ushtrimeve të ndryshme të cilat aplikohen në fitnes dhe bodybuilding me qëllim të arritjes së forcës muskulore, por edhe në karakteristikat dalluese të këtyre ushtrimeve varësisht nga qëllimi i subjektit që ushtron.

Ne faqet vijuse te keti punimi , une deshiroj te mirrem dhe te sqaroje me hollesishte per zhvillimin e forces me mjetet e fitnesit .

Qëllimi kryesor i punimi vijues është sqarimi i bazave të zhvillimit të forcës me mjetet e fitnesit . Me ane të këtij punimi do të theksojmë që të ushtruarit në fitnes është një lloj aktiviteti i cili me ndihmën e veglave zhvillon muskulaturen e sportistit .

Mu për këtë , mendoj që kjo nisme e imja të kontribuoj dhe ndihmojë sportistët të cilët deshirojnë të mirren me ushtrime me vegla të fitnesit të dedikuara për njerëzit që merren me fitness apo bodybuilding .

3.1.Benifitet e të ushtruarit me pesha

- shpejton metabolizmin e trupit ,
- rritin forcën dhe rezistencën e trupit ,
- të bën të ndjeheni me energjik dhe më i fuqishëm ,
- të përmirësojë energjinë mendore ,
- ju bën më të shkathët në punët e përditshme ,
- përmirësojnë tonusin e muskujve ,
- ndihmojnë në balancën dhe koordinimin e trupit ,
- e rrit sasinë e djegjes së dhjamit ,
- forcojnë ligamentet dhe tendonat ,
- përmirësojnë dukjen e jashtme të trupit ,

Pas moshës 30 vjeçare , njerëzit fillojnë të humbin masën e eshtrave dhe masën muskulare , studimet e fundit kanë treguar se ushtrimet me pesha dukshëm zvogëlojnë humbjen e eshtrave dhe muskujve dhe ndihmojnë në parandalimin e sëmundjes së osteoporozës.

Ushtrimet me pesha ju bëjnë të ndiheni me energjik dhe ju ndihmojnë në zvogëlimin e stresit dhe depresionit .

Në këtë punim do të paraqesim komplekse të ndryshme të ushtrimeve me përshkrimin terminologjik si dhe paraqitjen me ilustrime fotografike.

Për çdo ushtrim veq e veq do të përshkruhet:

pozita fillestare e subjektit, detyra – ku është përshkruar shkurtimisht struktura e lëvizjes që realizohet,

llojet dhe pozitat në vendushtrim,

qëllimi i realizimit të lëvizjes /ushtrimit/ me ndikim në muskuj dhe grupe të caktuara muskulare,

numri i përsëritjeve për çdo ushtrim.

dedikimit të caktuar të ushtrimit, konform nevojave dhe qëllimeve të sportistit

karakteristikat kryesore të rekuizitave për ushtrime et,

Në këtë punimi do të trajtohet në mënyrë të veçantë edhe aspekti aplikimit të nutricionit, respektivisht vlerave nutritive karakteristike për personat të cilët ushtrojnë në mënyrë sistematike në fitnes dhe bodybuilding.



3.2. Klasifikimi i mjeteve në fitnes

Siç është shkruar edhe më lartë, mjetet për ushtrime, janë pajisje teknike të cilat sportistin e vënë në pozitë të caktuar (pozita këto të paraqitura dhe ilustruara me foto si më poshtë).

Këto pajisje dallojnë për nga forma konstruksionit si dhe nga qëllimi I aplikimit. Ushtruesi në këtë rast, duke i përdorur këto mjete dhe ngritur pasha të madhësive të ndryshme, realizon lëvizje (ushtrime) nga më të ndryshmet.

Rekuizitat kryesisht ndahen në dy grupe kryesore:

a/ të karakterit të përgjithshëm dhe

b/ specifik – special.

a/ Pajisjet e karakterit të përgjithshëm, shfrytëzohen për zhvillimin e dimensionit të forcës të karakterit të përgjithshëm dhe bazik. Këto mjete klasifikohen edhe sipas regjionit të caktuar topologjik muskolorë, respektivisht grupeve të caktuara të muskujve. Sipas këtij kriteri, këto mjete mundë të jenë të dedikuara si psh.

- për zhvillimin e forcës së krahëve dhe supeve
- muskujve të barkut dhe të shpinës si dhe
- muskujve të këmbëve.

B/ Pajisjet e karakterit specifik, janë mjete të cilat shfrytëzohen për zhvillimin e forcës e karakterit special (specifik), respektivisht forcës dhe dimensioneve tjera tipike të aktiviteteve të ndryshme sportive. Disa nga këto

mjete speciale janë psh. Mjetet e ndryshëm për zhvillimin e forcës pliometrike, mjete të cilat I shfrytëzojnë hedhësit e sferës, hedhësit e diskut, lundruesit me barkë etj.

Këto mjete karakterizohen me realizimin e lëvizjeve me ngarkesa në një e më shumë nyje. Karakteristikë tjetër është edhe stimulimi me lëvizje të cilat janë identike me strukturën e lëvizjeve tipike të aktivitetit konkret sportive me të cilën çirret / ushtron/ sportisti/.

Përparësia e këtyre mjeteve /pajisjeve/ qëndron gjithsesi në shumëllojshmërinë e realizimit të lëvizjeve me ngarkesa, me ç'rast disa faza të lëvizjeve krijojnë parakushte të volitshme për sforcim dhe realizim maksimal të forcës muskulore.

3.3.Karakteristikat e lëvizjeve – ushtrimeve

Në përcaktimin e amplitutës së lëvizjes më së shumti ndikojnë 1. qëllimi i ushtrimit, 2. konstruksioni i peshave (trenazherëve), dhe 3. nga fleksibiliteti i ushtruesit – sportistit.

Peshat e ashtuquajtura të lira, të cilat nuk bëjnë pjesë ne rekuizita komplekse, mundësojnë amplitudë më të madhe të lëvizjeve, e në veçanti peshat më të lehta. Në përgjithësi, amplituda e lëvizjeve përcaktohet në bazë të qëllimit dhe programit të ushtruarit.

Që të mos vie deri te dhembjet, ose lëndimet e padëshiruara gjatë ushtrimeve, lëvizjet duhet të realizohen në mënyrë të kontrolluar, duke i paraprirë çdo herë nxemja e mjaftuar e muskujve dhe nyjeve.

3.4.Rëndësia e frymëmarrjes

Gjatë të ushtruarit, frymëmarrja është tejet e rëndësishme. Përveç tjerash në mënyrë të rregullt duhet të furnizohen me oksigjen truri, mushkëritë dhe zemra.

Frymëmarrja e drejtë dhe me ritëm mundëson përsëritjen e ushtrimeve në kohëzgjatje të caktuar dhe pa pengesa. Frymëmarrja e rregullt gjithashtu eviton paraqitjen e mundimeve të ndryshme si: marramendje, dezorientimin, ngritjen e shpejtë të shtypjes së gjakut etj.

Te ushtrimet me pesha, frymëmarrja realizohet gjatë fazës ekscentrike, ndërsa gjatë fazës koncentrike, respektivisht gjatë përfundimit të fazës së lëvizjes realizohet ekspirimi (lëshimi i frymës). Në këtë rast theksojmë një moment të veçantë i lidhur me lëshimin e ajrit. Lëshimi i plotë i ajrit duhet të jetë i theksuar në interval të shkurtër kohorë. Ky moment ndodh në fazën përfundimtare të lëvizjes ose ngritjes së peshës, ndërsa gjatë fazës ekscentrike frymëmarrja duhet të jetë e njëtrajtshme.

4. Stërvitja individuale e forcës

4.1. Fazat e trajnimit të forcës.

1. **Faza epërgatitore** është faza fillestare e programit për trajnimin e forcës. Qëllimi është për të ndihmuar ndërtimin e muskujve të qëndrueshëm dhe një bazë kondicionale për të përgatitur trupin në mënyrë të sigurt përfazën e trajnimit të forcës me intensitet të lartë që do të pasojnë. Intensiteti i trajnimit është i ulët dhe vëllimi është i lartë gjatë fazës përgatitore.

2. **Faza erritjes së masës muskulare ose e hipertrofisë** është e rëndësishme sepse ajo përgatit atletët në dy mënyra kryesore përfazën me intensitet më të lartë për të ardhur më vonë në ciklin:

1. Hipertrofia muskulare është rritja e indeve të muskujve, si rezultat i përshtatjes specifike fiziologjike të trajnimit. Rritja e indeve të muskujve përmirëson shanset e zhvillimit të forcës dhe fuqisë .

2. Kapaciteti anaerob i atletëve, ose qëndrueshmëria specifike mund të përmirësohen ndjeshëm me stërvitjet me pesha në sallë. Përmirësimi i kapacitetit anaerob do të ëndihmonte në fazat e mëvonshme të ciklit të trajnimit.

3. **Faza themelore e Forcës** është në mes të fazës hipertrofisë dhe fazës së forcës dhe fuqisë. Rrit zhvillimin e forcës në të gjitha grujat e mëdha që ndodhin në këtë fazë. Intensiteti i trajnimit është i lartë për këtë fazë dhe shërben për të rritur forcën dhe intensitetin si dhe ndihmon për tu përgatitur për fazën e forcës e fuqisë .

4. **Faza e Forcës dhe Fuqisë**- kaintensitet më të lartë dhe karënie në volum. Kjo ndihmon në zhvillimin e vazhdueshëm të forcës dhe fuqisë duke zvogëluar përsëritjet dhe duke u fokusuar në objektivat e seteve pa u lodhur që lidhet me fazën e lartë të përsëritjeve . Kjo është gjithashtu e njohur si faza e kulmit.

5. **Fazat sezonale e mirëmbajtjes** është dizajnuar për të ndihmuar atletëve që të ruajnë sa më shumë forcën dhe fuqinë që është fituar edhe jashtë sezonit të garave.

6. **Faza e Pushimit aktiv** është quajtur edhe pas sezonit, kjo fazë zgjat varësisht nga plasmani i ekipes në garat shtes (Play-off) apo pjesmarrja në ligat e ndryshme.

Gjatësia e ndryshojnë varësi të situatës. Gjatë kësaj kohe trupi dhe mendja duhet të marrin veten nga stresi që kanë pësuar gjatë sezonit. Aktivitetet duhet të jenë me intensitet të ulët dhe

vëllim të lartë për të lejuar trupin që të shërohet. Dystërvitjetë lehta në javë me 1 deri në 2 grupe nga 15 në 20 përsëritje për rishtrim është një parametër i mirë për këtë fazë.

Stërvitja e forcës përfshinë përdorimin e një rezistence për rritjen e forcës. Rezistenca mund të vijë nga disa burime të ndryshme si p.sh. pesha e trupit (në ngritja në hekur me forcë), pesha të lira, topi i rëndë mjekësor, rekuizita të ndryshme, breza të llastikut, makineri etj. Çdo mjet është thjesht shfrytëzim për rritje të një rezistence. Asnjë mjet nuk garanton rezultate, por ndikon tërthorazi për të arritur qëllimin final. Asnjë mjet nuk është më i mirë apo më i keq se tjetri. Secili ka vlerë nëse përdoret si duhet.

Shumë trajnerë përkrahin mendimin e heqjes së peshës nga përdorimi, pasi interpretimi i tyre për këtë frazë është i ngjashëm me ndërtimin e trupit. Termi tërheqja e peshës e bën njeriun ta paramendojë automatikisht një bodybuilder me muskuj të mëdhenj.

Ka shumë botime për stërvitjen me pesha të rënda që në mënyrë të gabuar supozojnë se metoda të tilla do të ndikojnë negativisht në shpejtësinë. Ekziston mit i zakonshëm që thotë se trajnimi me pesha të rënda do të çojë në masë të panevojshme muskulare, e cila rrjedhimisht do të zvogëlojë lëvizjen dhe shpejtësinë e zhvillimit. Kjo është krejtësisht e pavërtetë. Kur analizohet mirë se funksionon trupit atëherë, shpejt kuptohet se një program i fuqisë i projektuar për të rritur efikasitetin e fibrave të shpejta të muskujve nuk do të dëmtojë potencialin e shpejtësisë. Përkundrazi, programi i duhur mund të ndihmojë me prodhimin e shpejtësisë. Ky konkluzion vëhet në dukje nga autorë të ndryshëm. Tjetër gjë është nëse stërvitja me pesha bëhet gabimisht, ose nëse dëshiron të bëhesh njeri me i fortë për peshëngritje.

Gjithashtu, ka botime që thonë se stërvitja me pesha e redukton fleksibilitetin. Edhe kjo është e gabuar. Sportet e ndryshme janë komplekse të ndërlydhura me realizimin e lëvizjeve të ndryshme, p.sh. ju përdorni muskulin biceps-triceps dhe muskuj të tjerë që ndihmojnë që të godasim dhe të kthehet dora mbrapa. Sa më shpejtë që këta muskuj kontrahohen dhe lëvizin aq më e fuqishme dhe racionale do të jetë lëvizja.

5. Modeli i stërvitjes me pesha


Stërvitja sistematike me pesha është përdorimi i vazhdueshëm i një rezistence (peshës së caktuar apo veglës në të cilën ushtrohet) e cila përmirëson fuqinë, funksionimin e muskujve dhe forcën e atletit. Forcon grupet e muskujve më të dobët dhe ndihmon në rritjen e forces muskulare.

Megjithatë ekzistojnë disa elemente përgjithëse. Për të parë mundësimin e përmirësimit me ushtrime force të atletit që ushtron duhet qësë pari të shikojmë grupet e muskujve më të përdorur dhe në bazë të këtij informacioni identifikojmë ushtrimet më të mira për këto muskuj.

5.1. Modeli i një orë stërvitje për zhvillimin e qëndrueshmërisë muskulore - muskujve të gjoksit

Përshkrimi i ushtrimeve, pozita fillestare, numri i përsëritjeve, pushimi ndërmjet serive etj.

Ushtrime për zhvillimin e muskujve të gjoksit



Ngritja e peshës I shtrirë në arkë



Pozicioni fillestar



Pozicioni perfundimtar

- **Përshkrimi**

I shtrirë në shpinë në stolin e përkulur

Gjoksi lart gjatë gjithë kohës, një lakim i vogël në bel

Kërrysjen e brylave me ulet se pjesa e sipërme e gjoksit

Shtyini peshat deri kur krahet janë zgjatur mbrapa

- **Këshillat**

Nxirreni frymen jashtë kur i ngrini peshat lartë

- **Gabimet**

Ngritja e peshave jo përmbi pjesën e sipërme të gjoksit

Ngritjen e këmbëve nga toka kur i ngrëjmë peshat

- **Seritë**

1x14 1x12 1x10

- **Pushimi**

60-90 sekonda mes çdo serie

Ngritja e peshave të vogla (Dumbbell Bench Press)



Pozicioni fillestar



Pozicioni perfundimtar

- **Përshkrimi**

Qëndrim në stol i shtrirë me këmbë të vendosura në tokë, mbajmë peshën mbi gjoks, me krahet e drejtë

Gjoksi lart gjatë gjithë kohës, një lakim i vogël në bel

Uleni peshat ngadal deri sa të arrij në nivelin e gjoksit

Shtyjeni përsëri lart në krahe të drejte në pozitën fillestare

- **Këshillat**

Mbajtja e gjoksit lart

- **Gabimet**

Mosmajtja e gjoksit lart

Lakim i tepërt në bel

Lëvizja e trupit gjatë ekzekutimit të ushtrimit

Shtyrja e kokës mbrapa kundrejt stolit

- **Seritë**

1x14 1x12 1x12 1x10

- **Pushimi**

60-90 sekonda mes çdo serie

Ngritja e shufrës (shitangës) -Barbell Bench Press



Pozicioni fillestar



Pozicioni perfundimtar

- **Përshkrimi**

Qëndrim në stol i shtrirë me këmbë të vendosura në tokë, mbajmë hekurin mbi gjoks me krahet e drejtë, duart vendosen pak më të hapura se madhësia e shpatullave

Gjoksi lart gjatë gjithë kohës, një lakim i vogël në bel

Uleni hekurin ngadal deri sa të arrijë në nivelin e gjoksit

Shtyjeni përseri lart në krahe të drejte deri në pozitën fillestare

- **Këshillat**

Mbajtja e gjoksit lart

- **Gabimet**

Mosmajtja e gjoksit lart

Lakim i tepërt në bel

Lëvizja e trupit gjatë ekzekutimit të ushtrimit

Shtyrja e kokës mbrapa kundrejt stolit

- **Seritë**

1x14 1x12 1x10

- **Pushimi**

60-90 sekonda mes çdo serie

Shtytja e peshës para



Pozicioni fillestar



Pozicioni perfundimtar

- **Përshkrimi**

Uleni stolin në nivel që dorezat të jenë në nivelin e gjoksit tuaj

Të ulur dhe e mbani gjoksi lart, shtyni përpara gjoksit të dyja duart njëkohësisht

Ngadal i tërhiqni duart mbrapa në pozicionin fillestar

- **Këshillat**

Mbajtja e gjoksit lart

- **Gabimet**

Nxjerja e shpatullave përpara

Harkimin e tepërt të trupit

- **Seritë**

1x12 1x10 1x10

- **Pushimi**

60-90 sekonda mes çdo serie

Shtytje anësore -Pectoral Fly



Pozicioni fillestar



Pozicioni perfundimtar

- **Përshkrimi**

Ulur në vegël dhe mbani dorezat
Shtyni dorezat njëkohësisht përpara
